



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
**MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**

Barbullushi Odeta
Zëvendësministër



Deputy Minister for Foreign Affairs,
Republic of Albania
**Zv/Ministre e Puneve të Jashtme që
nga Janari 2015.**

Odeta Barbullushi ka marrë detyrën e Zëvendësministres së Punëve të Jashtme në janar 2015. Portofoli i saj në MPJ mbulon kryesisht marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e rajonit, si në nivel dypalësh ashtu dhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare, gjithashtu dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në dhe me shtetet anëtare të BE-së. Përgjegjësitë e tjera përfshijnë çështje që lidhen me sigurinë europiane dhe rajonale.

Znj. Barbullushi mban titullin Doktor i Filozofisë (PhD) në Studime Ruse dhe të Evropës Lindore nga Universiteti i Birmingamit në Mbretërinë e Bashkuar (2009), dhe atë të Profesor i Asociuar në Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti i Tiranës (2015). Formimi profesional i znj. Barbullushi është kryesisht akademik dhe i fokusuar në çështjet e shtet-formimit dhe politikës së jashtme të Shqipërisë, teoritë dhe historia e nacionalizmit dhe shtetformimit në Europën Lindore dhe Qendrore, etj. Gjatë studimeve universitare, znj. Barbullushi ka punuar në sektorin e mediave dhe të komunikimit.

Përvoja Profesionale

2013 Universiteti i Grazit Karl-Franzen, Austri, Studime kërkimore post-doktorale

2009-2014 Universiteti Europian i Tiranës, Shqipëri, Lektore

2012-2014 Universiteti Europian i Tiranës, Shqipëri, Zëvendës Rektore

2009-2011 Universiteti Europian i Tiranës, Përgjegjëse e Departamentit të Marrëdhënieve Shkencave Politike dhe Ndërkombëtare

2007-2008 Instituti i Kërkimeve Europiane, Universiteti i Birmingamit, Mbretëria e Bashkuar, Lektore

2001-2002 Mission without Borders, Shqipëri, Përgjegjëse për Komunikimin.

Arsimi

2010 University of Birmingham, Mbretëria e Bashkuar, PhD në Studime Ruse dhe të Evropës Lindore

2004 Sussex European Institute, Mbretëria e Bashkuar, Master në Studime Bashkëkohore Europiane

2003 Central European University, Hungari, Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane

2001 Universiteti i Tiranës, Shqipëri, Bachelor në Gazetari

1997 Riverside School, Zug, Zvicër, Diplomë e Shkollës së Mesme

Bordet profesionale dhe anëtarësimet

2014 Anëtare e Komisionit të posaçëm për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri (dha dorëheqjen pas marrjes së detyrës publike)

Çmimet/Bursat

2013 Ernst Mach Global Fellowship

2012 Honorary Research Fellow, University of Roehampton, Mbretëria e Bashkuar

2009 Brain Gain Incentive Grant

2004 Dorothy Hodgkin Postgraduate Award
2002 OSI Fellowship for Postgraduate Studies

Mësimdhënie

Analiza e Politikës së Jashtme (Master, 2009-2017)

Çështja Shqiptare dhe Politika e Jashtme e Shqipërisë (Bachelor, 2009-2014)

Politika e Jashtme e Krahasuar (Bachelor, 2009-2014)

Historia politike e Europës Qendrore dhe Lindore në shekullin e 20-të (Bachelor, 2008)

BE-ja në një botë të globalizuar (Bachelor, 2008)

Metodat e Avancuara Kërkimore në Shkencat Sociale (Master/Doktorature, 2009-2015)

Drejtim dhe Koordinim Projektesh

2011-2014 Menaxhere dhe Koordinatore e projektit rajonal Tempus "Zhvillimi i të drejtave të njeriut në qendër të arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor".

2010-2011 Studiuuese, Hulumtimet sociale dhe hartimi i politikave në Shqipëri. Projekt i financuar nga Programi Rajonal për Promovimin e Kërkimeve në Ballkanin Perëndimor (RRPP), Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Departamenti Federal Zviceran i Punëve të Jashtme